



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0025383-2/ dt. 13.05.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0025383/26, dt. 05.05.2026, të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për formimin e Komisionit për hartimin e Draft – Rregullores për Ndryshim/
Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2023 Për Shfrytëzimin e Përkohshëm të
Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike)

- FORMOHET** Komisioni për hartimin e Draft – Rregullores për Ndryshim/
Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2023 Për Shfrytëzimin e Përkohshëm të
Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike, në këtë përbërje:
 - 1.1 Xhevdet Aruqaj – kryetar (DPU);
 - 1.2 Mevlyde Shala Peci – anëtare (DBF);
 - 1.3 Bedri Muja – anëtar (DI);
 - 1.4 Shenaj Llapashtica – anëtare (DPU);
 - 1.5 Erduan Jashari – anëtar (DPU);
- Komisioni është përgjegjës që të bëjë hartimin e Draft - Rregullores për Ndryshim/
Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2023 Për Shfrytëzimin e Përkohshëm të
Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike, duke përfshirë të gjitha propozimet nga
drejtoritë komunale që implikohen në zbatimin e saj, dhe të bëjë harmonizimin e
tyre me dispozitat ligjore pozitive në fuqi.
- Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft - Rregullores së lartcekur të
njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për Shqyrtim dhe Miratim përmes
Kryetarit të Komunës.
- Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 03/L-040 për
Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme
Administrative, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020,
Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikinin e
Akteve të Komunës, Rregulloren Nr. 01/2023 Për Shfrytëzimin e Përkohshëm të



Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi obligohet që të hartoj Draft-Rregulloren në afat më së largu brenda 3 (tre) muajsh, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Shtojcë:

Propozim-Vendimi Nr. 01-020/04-0025383/26, dt. 05.05.2026, të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm.

T'i dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit

